

Fillimi > -Kronikë

VIDEO/ Ushtroi dhunë ndaj bashkëshortes dhe e kanosi me armë zjarri, arrestohet 37-vjeçari në Kamzë (EMRI)

05 Shtator, 2022 09:28



Madhësia e tekstit: - +

Parandalohet një ngjarje e rëndë kriminale në një familje në Kamzë.

Një 37-vjeçar ka rënë në prangat e policisë, pasi akuzohet se ka ushtruar dhunë ndaj gruas dhe më pas e ka kanosur atë me armë zjarri.

Gazetari Igli Çelmeta raporton se bëhet fjalë për shtetasin Marash Mexhaj.

NJOFTIMI I POLICISE
Falë ndërhyrjes në kohë nga shërbimet e Policisë, u parandalua një ngjarje e mundshme kriminale në familje. Vihet në pranga 37-vjeçari që ushtroi dhunë ndaj bashkëshortes dhe e kanosi atë me armë zjarri.

Sekuestrohen një armë zjarri pistoletë me fishek në fole gati për qitje, municion luftarak dhe 5 radio që dyshohet se lidheshin me valët e radiove të Policisë.

Shërbimet e Komisarariatit të Policisë Nr. 5, bazuar në informacionet e marra në rrugë operative se në fshatin Kasallë një shtetas mbante armë zjarri dhe ushtronte dhunë ndaj bashkëshortes, menjëherë kanë organizuar punën dhe kanë finalizuar operacionin policor të koduar “Kasalla”.

Si rezultat i tij u bë kapja dhe arrestimi në flagrancë i shtetasit:

– M. M., 37 vjeç, për veprat penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit” dhe “Dhuna në familje”.

Shtetasi M. M., mbrëmjen e djeshme ka ushtruar dhunë ndaj bashkëshortes së tij dhe e ka kanosur atë. Ky shtetas në momentin që kanë arritur shërbimet e Policisë, ka hedhur armën e zjarrit pistoletë nga dritarja e banesës dhe ka tentuar të largohet, por është prangosur nga shërbimet e Policisë.

Gjatë kontrollit përreth banesës, shërbimet e Policisë gjetën dhe sekuestruan, në cilësinë e provës materiale, një armë zjarri pistoletë me fishek në fole gati për qitje. Po gjatë kontrollit në banesë, Policia gjeti dhe sekuestroi municion luftarak, një këllëf pistolette si ato të Policisë dhe 5 radio që dyshohet se lidheshin me valët e radiove të Policisë.

Materialet i kaluan Prokurorisë, për veprime të mëtejshme.

Për t'u bërë pjesë e grupit "Balkanweb" mjafton të klikoni: [Join Group](#) dhe kërkesa do t'ju aprovohet menjëherë. [Grupi Balkanweb](#)

Etiketa: kamze

TË NGJASHME



Dhunonte gruan dhe djalin e mitur, arrestohet trafikanti i kokainës në Kamzë, çfarë i gjendet në banesë


12 Qershor, 2022



Ndërron jetë punonjësi i policisë në Kamzë, dyshimet e para

07 Qershor, 2022

TË FUNDIT NGA -KRONIKË



Klodiana Lala | 05 Shtator, 2022



"Do gjendet në një shtëpi", paralajmërimi "bombë" i Karamuços: Fletorja me emrat e drejtorëve të policisë që marrin rrogë nga krimi

05 Shtator, 2022




Të shtëna me armë zjarri në Bulqizë, dyshohet se..

05 Shtator, 2022




Zhdukja e Evis Martinajt, zbulohet mesazhi i fundit në celularin e xhaxhait. Ish-efektivi që i mundësonte lëvizjen e lirë të shumëkërkuarit, 'çelësi' për pikëpyetjet e hetuesve

05 Shtator, 2022



05 Shtator, 2022



U kapën duke transportuar 50 emigrantë, kush janë 3 të rinjtë e arrestuar (EMRAT)


05 Shtator, 2022

KATEGORIA VIDEO




Zbardhet propozimi i PL-së/ Kërkesë në Kuvend për rritjen e pagës së administratës publike (Dokumentet)

05 Shtator, 2022



Aksion i paligjshëm i IKMT në 'Prestige Resort', deputeti i PD, Gështenja: Kërcënim i hapur për këdo që s'i bindet Ramës. Shqiptarët duhet të reagojnë!

05 Shtator, 2022




Klodiana Lala | 05 Shtator, 2022



VIDEO/ Qytetarët të shokuar për situatën në "Prestige Resort": Në këtë vend nuk ka më shpresë! Rama arrogant dhe hakmarrës

05 Shtator, 2022



05 Shtator, 2022



A do të huazoni tri deputetë për një grup të ri parlamentar? Meta: Shteti u shkri në një parti! Mos u habisni kur të më shihni para...

05 Shtator, 2022



FAQET ZYRTARE

TV News24 Live

News24.al

Radio RASH

PRIVATËSIA

POLITIKA E PRIVATËSISE

KONTAKT

redaksia@balkanweb.com

Alert

Autokonët

Dola te Ola

Emisioni Vila 24

Fit Station

Frontline

Jeta_pa_filtër

Kjo Javë

Klinika 24

Koha për t'u zgjuar

Në mëngjes me Klarkun

Në shënjestër

Open

Pikat mbi i

Rrugëtim me Anilën

Sport News

Sport News Plus

Fillimi

Shqipëria

Kosova

Rajoni

Sport

Bota

Kulturë

Metropol

Analiza

Teknologji

New York Times

Guardian

WEB BBC

WEB CNN

REUTERS

Washington Post

Times Online

Financial Times

WEB Yahoo

WEB MSN

USA Today